



6560
28.04 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NDËRMARRJA E PASTRIMIT

Nr. 93/1 prot.

Vlorë, më 25.04 2025

Lënda: Informacion mbi gjendjen e pastrimit, problematikave dhe masave të marra.

KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE ✓

Për dijeni: Drejtorit të Kabinetit

Në përgjigje suajës me nr. 5701 prot. datë 11.04.2025, me hyrje në Ndërmarrje me nr. 93 prot. datë 17.04.2025 ju informojmë se:

Ndërmarrja e Pastrimit kryen shërbimin në 5 Rajonet e qytetit të Vlorës dhe në Njësinë Administrative Orikum.

Ky shërbim kryhet me mjete teknologjike për evadimin e mbetjeve urbane nga kontenierët, me kamioncina për evadimin e inerteve të hedhura nga qytetarët dhe bizneset e papërgjegjshëm, skrep dhe kamion për pikat e nxehta kur sasia e mbetjeve është shumë e madhe dhe nuk mund të kryhet me kamioncinë me punëtor, autobot për larjen e rrugëve me presion, plugimin dhe pastrimin e plazhit, fshirjen e rrugëve dhe trotuareve me autofshesë dhe fshirjen e rrugëve, trotuareve, blloqeve të banimit me fshesë me punëtor.

Gjatë procesit të punës kemi konstatuar këto problematika:

1. Vendgrumbullimi i mbetjeve i cili i shërben qytetit prej viteve 70 është në limitet e tij.

Problematikë e madhe është sasia e madhe e mbetjeve duke e bërë të pamundur krijimin e hapësirave të reja në këtë vendgrumbullim.

Kjo sasi e madhe mbetjesh ditore bën që ne të afrohem sa më shumë qendrave të banimit duke qenë një rrezik i shtuar për infeksione si dhe rreziqet nga zjarri.

Vendosja në punë e landfieldit të ri është prioritet dhe duhet ndërhyrje emergjente për rehabilitimin e vendgrumbullimit ekzistues dhe depozitimin e mbetjeve në landfieldin e ri të Sherishtës.

2. Papërgjegjshmëria qytetare:

Adresa: Lagjja: "Kushtrimi", ish Parku i Autobuzave, Vlorë, e-mail: pastrimivlorë@gmail.com

- a. Në hedhjen e mbeturinave në koshat e vegjel
- b. Hedhja e mbeturinave jashtë kontenierëve.
- c. Parkimi i makinave në pikat e kontenierëve duke krijuar vështirësi deri në mos heqjen e mbeturinave duke krijuar dhe trafik për shkak të pritjes së zhbllokimit të pikës së kontenierëve.
- d. Papërgjegjshmëria e bizneseve. Hedhja e mbeturinave, kartonave të pa sistemuar sidomos nga supermarketet në orare të papërshtatshme duke i tejmbushur kontenierët dhe duke krijuar vështirësi për qytetarët.

Pajisja me kamera do të ndihmonte në evidentimin, marrjen e masave dhe parandalimin e qytetarëve dhe bizneseve të cilët hedhin mbetjet në mënyrë të papërgjegjshme.

3. Punimet në infrastrukturën rrugore na vështirëson transportin e kontenierëve nga pika te mjeti teknologjik dhe në fshirjen e rrugëve.
4. Numri i ulët i punëtorëve: Vazhdimisht kemi bërë kërkesën për shtimin e numrit të punëtorëve të fshesës pasi ky numër është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjithë sipërfaqen e rrugëve, trotuareve, shesheve dhe blloqeve të banimit në qytetin e Vlorës.
5. Nga ndryshimet që janë bërë në urbanistikën e qytetit janë bërë vazhdimisht kërkesa nga ana e qytetarëve dhe bizneseve për shtimin ose zhvendosjen e pikave të kontenierëve.

Nga ana Ndërmarrjes së Pastrimit janë bërë vazhdimisht njoftime Policisë Bashkiake për marrjen e masave. Gjithashtu kemi komunikuar me subjekte private dhe qytetarët për sensibilizimin për mbrojtjen dhe ruajtjen e ambjentit të pastër sipas udhëzimeve në fletëpalosjet e shpërndara.

DREJTOR

Francesko Tozaj

